



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



VLERËSIMI I KONKURENCËS NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË 2018-2019

Prishtinë, dhjetor, 2020

Shkurtesat	3
1. Hyrje	4
2. Baza Ligjore	5
3. Akterët kryesor dhe roli i tyre në tregun e energjisë elektrike.....	7
4. Përshkrimi i tregut të energjisë elektrike në Kosovë	8
5. Tregu i energjisë elektrike me shumicë	10
5.1 Konkurrenca në tregun me shumicë.....	11
6. Tregu i energjisë elektrike me Pakicë	12
6.1 Konkurrenca në tregun me pakicë.....	12
7. Indeksi Herfindahl - Hirschman (HHI)	14
8. Konkluzione.....	15

Shkurtesat

ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
OT	Operatori Tregut
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
KESCO	Kompania për furnizim me energji elektrike e Kosovës
KEDS	Kompania Kosovare për Distribim me Energji Elektrike
MZHE	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
BE	Bashkimi Evropian
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
MFSH	Marrëveshja për Furnizim me Shumicë (KEK-KEDS)
EFET	Federata Evropiane e Tregtarëve të Energjisë
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
AKK	Agjencioni Kosovar i Konkurrencës

1. Hyrje

Viteve të fundit në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë ka pasur zhvillime të rëndësishme. Këtyre zhvillimeve ju paraprijnë shturja e ndërmarrjeve vertikalisht të integruara, dhe ndryshimet në legjislacion duke mundësuar zbatimin e reformave në sektorin e energjisë elektrike dhe përgatitjen për liberalizimin e tregut.

Në vitin 2016 janë miratuar ligjet e reja të energjisë: Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike, Ligji për Rregullatorin e Energjisë. Këto ligje janë pjesërisht në përputhje me pakon e tretë gjegjësisht me Direktivën Nr.2009/72/EC, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe Rregulloren Nr.714/2009/EC, për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, si dhe me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Pas ndryshimeve në legjislacionin primar, është harmonizuar edhe legjislacioni sekondar për sektorin e Energjisë, duke mundësuar funksionimin e tregut të energjisë në pajtueshmëri me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Zyra e Rregullatorit për Energji është duke ndërmarr masat e nevojshme për zbatimin e reformave në sektorin e energjisë elektrike, në rrafshin legjislativ dhe implementimin e tyre në praktikë.

Rritja e efikasitetit në sektorin e energjisë është thelbësore për të përballuar sfidat e paraqitura nga rritja e konsumit, prandaj liberalizimi i tregut në sektorin e energjisë elektrike, njëjtë sikur edhe në industritë tjera, bëhet për faktin se konkurrenca në treg konsiderohet burim i efikasitetit të tregut, dhe kjo mund të aplikohet vetëm në një treg të hapur për secilin pjesëmarrës në të. Praktikrat e tregjeve konkurruese tregojnë se në ato rrethana jepen sinjalet e duhura në lidhje me prodhimin, kërkesën dhe investimet për pjesëmarrësit në sektorin e energjisë.

Duke pasur parasysh se në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë kemi monopole natyrore, procesi i liberalizimit të tregut është më i vështirë, megjithatë prezenca e konkurrencës në treg është thelbësore në mënyrë që liberalizimi i tregut të jep fryte për sa i përket efikasitetit ekonomik.

Sektorin e energjisë elektrike përcillet me monopol natyror, siç janë rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, pa marrë parasysh nëse një rrjetë operohet nga operator publik apo privat. Liberalizimi i tregut mundëson konkurrencën në treg dhe duhet të futet që nga faza e gjenerimit e deri tek shfrytëzuesi i fundit i energjisë elektrike.

Përmes këtij raporti të përgatitur nga ZRRE do të vlerësohet konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë të energjisë elektrike në vend, për periudhën 2018-2019. Prezenca e konkurrencës në tregun e brendshëm do të vlerësohet duke u krahasuar gjendja ekzistuese e tregut me kërkesat ligjore sipas legjislacionit primarë dhe sekondar të sektorit të energjisë në Kosovë, aplikimin e indikatorit për matjen e përqendrimit të tregut HHI, përfshirë edhe vendimin e Bordit të Rregullatorit V_342_2011 për Kriteret për Vlerësimin e Konkurrencës në Furnizim me Energji Elektrike në Kosovë.

Ky raport paraqet vlerësimin e ZRRE-së nëse ka:

- konkurrencë efektive në tregun e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë, dhe
- karakteristika të tregut që mund të dëmtojnë konkurrencën efektive.

2. Baza Ligjore

Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) - është agjenci e pavarur dhe e ndarë në aspektin ligjor dhe funksional nga çdo person tjetër fizik a juridik. Detyrat dhe funksionet e Rregullatorit janë të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr.05/L_084, të cilat përfshijnë: krijimin dhe funksionimin efikas, transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve si dhe dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve dhe dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja; monitorimin e tregut dhe përkujdesjen për përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji; vendosjen e tarifave për aktivitetet e energjisë në mënyrë të arsyeshme dhe në bazë të metodologjisë tarifore; monitorimin dhe parandalimin e krijimit të pozitës dominuese dhe praktikave jo-konkurrese nga ndërmarrjet e energjisë, si dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë.

Ligji për Rregullatorin e Energjisë 05/L/084, neni 15 - ndër të tjera përcakton edhe përgjegjësinë për vlerësimin e funksionimit të tregut dhe konkurrencës ku thuhet: *Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim:*

“1.2. të përkujdeset për funksionim transparent dhe jodiskriminues të tregjeve të energjisë, duke u bazuar në parimet e tregut të lirë, sa u përket aktiviteteve konkurruese dhe aktiviteteve të rregulluara;”

Një nga përgjegjësitë e Rregullatorit, për të mbrojtur konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal, është edhe ngarkimi i obligimit të shërbimit publik për ndërmarrjet e energjisë. Për të ngarkuar ndërmarrjen e energjisë me këtë obligim, Rregullatori duhet të veprojë në pajtim me Nenin 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ku përveç tjerash thuhet:

“1.3. të bëjë vlerësimin e rregullt të efekteve të mundshme të obligimeve të shërbimit publik mbi konkurrencën vendore dhe ndërkombëtare në tregjet e energjisë, si dhe të konsiderojë nëse këto obligime duhet rishqyrtuar apo jo.”

Po ashtu sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, në kuadër të kompetencave të tij, Rregullatori zbaton masa të cilat kanë për qëllim parandalimin e shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Energji, neni 22 dhe 23, që kanë të bëjnë me ndalimin e kufizimeve të konkurrencës, respektivisht ndalimin e keqpërdorimit të pozitës dominuese në treg.

Ndërsa, sipas ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L_085, neni 26, përveç tjerash përcakton si vijon:

Paragrafi 1. *“Rregullatori, në konsultim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe me Zyrën e Ndihmës Shtetërore, së paku çdo dy (2) vite duhet të kryejë hetime lidhur me funksionimin e tregut të energjisë elektrike.”*

“Paragrafi 2. Rregullatori mund të përcaktojë masa të nevojshme dhe proporcionale të obligimeve të shërbimit publik, me qëllim të nxitjes të konkurrencës efektive dhe për të siguruar funksionimin e rregullt të tregut të energjisë elektrike. Këto masa mund të përfshijnë programet për ofrimin në treg të sasive të caktuara të energjisë elektrike, sipas të cilit subjektet obligohen të shesin ose të vënë në disponim sasi të

caktuara të energjisë elektrike ose mundësimin e qasjes në një pjesë të kapaciteteve të tyre prodhuese, furnizuesve të interesuar, për një periudhë kohore të caktuar.”

Ndërsa Ligji për Energji Nr.05/L_081, përkatësisht neni 24 përcakton kompetencat e organeve rregullatore lidhur me çështjet e konkurrencës si në vijim: -

“2. Nëse Rregullatori mbledh dëshmi të arsyeshme mbi një shkelje aktuale ose të dyshuar sipas dispozitave të nenit 22 dhe 23 të këtij ligji nga një ndërmarrje e energjisë, Rregullatori i dorëzon këto dëshmi në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës iniciuon një hetim të shkeljes së pohuar dhe merr çfarëdo mase zbatuese të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për korrigjimin ose adresimin e shkeljes së pohuar në përputhje me Ligjin për Konkurrencën.”

“3. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kryen një hetim, qoftë në bazë të informatave të marra nga Rregullatori ose nga çfarëdo burimi tjetër, përfshirë edhe me veprime të veta, mbi një shkelje të pohuar ose potenciale nga një ndërmarrje e energjisë të Ligjit për Konkurrencën sipas nenit 22 apo 23 të këtij ligji, Rregullatori do të ndihmoj Autoritetin Kosovar të Konkurrencës në kryerjen e këtij hetimi dhe vlerësimin e shkeljes së pohuar.”

Edhe pse ZRRE dhe AKK obligohen të nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi për ti plotësuar kërkesat që dalin nga neni 24 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, nje gjë e tillë ende nuk ka ndodhur.

3. Akterët kryesor dhe roli i tyre në tregun e energjisë elektrike

Prodhuesi (gjeneratori), është personi fizik ose juridik që prodhon energjinë elektrike, i cili mundë të jetë i kyçur në rrjetin e transmetimit apo të shpërndarjes. Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga KEK (TC “Kosova A” dhe TC “Kosova B”) dhe HC Ujmani të cilat janë në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe gjeneratorët tjerë në kuadër të BRE-ve që janë në pronësi private.

Operatori i Tregut (OT), është përgjegjës për organizimin, operimin dhe menaxhimin e tregut të energjisë elektrike në tërë territorin e Republikës së Kosovës në përputhje me Rregullat e Tregut të miratuara nga Rregullatori. Veprimtaria që kryen Operatori i Tregut është e lidhur me menaxhimin e tregut të energjisë elektrike dhe përgatitjen e raporteve financiare për pjesëmarrësit e tregut sipas Barazimit Përfundimtarë, pa përfshirë blerjen apo shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e rregullave të tregut.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), është person fizik, ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët me sistemet tjera, dhe për të garantuar aftësinë afatgjate të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike, si dhe balancimin e sistemit.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) – është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike. Gjithashtu OSSH ofron menaxhimin e bazave të të dhënave të matësve të konsumatorëve dhe mbledhjen e leximeve të njehsorëve për qëllime të barazimit përfundimtarë.

Furnizuesit – janë ndërmarrjet e energjisë të licencuara nga rregullatori, për të kryer veprimtarinë e furnizimit të konsumatorëve në Kosovë. Furnizimi me energji elektrike është aktiviteti i pavarur nga aktiviteti i transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike dhe ka të bëjë me blerjen, shitjen, duke përfshirë edhe rishitjen e energjisë elektrike te konsumatorët.

4. Përshkrimi i tregut të energjisë elektrike në Kosovë

Ristrukturimi i tregut të energjisë elektrike në Kosovë ka filluar që nga viti 2004 kur janë zhvilluar dhe aprovuar ligjet për sektorin e energjisë ku ndër të tjera është themeluar edhe Zyra e Rregullatorit për Energji. Procesi ka vazhduar me shthurjen e kompanisë vertikalisht të integruar KEK, dhe krijimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) në vitin 2006. Shthurja e mëtejme ka vazhduar me ndarjen e shpërndarjes dhe furnizimit nga KEK-u, të cilat janë privatizuar në maj të vitit 2013. Në viti 2015 është bërë shthurja ligjore e shpërndarjes nga furnizimi, që ka rezultuar me krijimin e dy kompanive: Operatori i sistemit të shpërndarjes (KEDS) dhe Furnizuesi i energjisë elektrike (KESCO).

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë kryesisht përfshinë tregtimin bilateral të energjisë elektrike. KOSTT operon me dy licenca: si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe si Operator i Tregut.

Operatori i tregut, përveç obligimeve tjera të përcaktuara me legjislacion është përgjegjës edhe për organizimin dhe operimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

Në Kosovë ende nuk ka treg të organizuar një-ditë-para apo brenda-ditës, andaj tregtimi i energjisë elektrike me shumicë kryhet kryesisht përmes kontratave bilaterale mes prodhuesve dhe furnizuesve (tregtarëve). Një pjesë e energjisë elektrike për të plotësuar kërkesën vendore për nevojat e konsumatorëve me të drejtën e furnizimit si shërbim universal (FSHU), për mbulimin e humbjeve të sistemit, si dhe për konsumatorët me çmime të derregulluara, importohet (blihet) përmes kontratave bilaterale në treg të lirë dhe/ose në tregjet rajonale të organizuara një-ditë-para apo brenda-ditës (përmes tregtarëve).

Energjia elektrike e prodhuar nga KEK sipas Marrëveshjes për Furnizim me Shumicë¹ (MFSH) ofrohet për Furnizuesin që furnizon konsumatorët me të drejtë të Shërbimit Universal dhe për mbulimin e humbjeve të sistemit, si dhe tepricat tregtohen në tregun me shumicë në pajtim me “Procedurën për Tregtimin e Energjisë elektrike²”.

Sipas kërkesave ligjore, çmimet e prodhimit janë të derregulluara nga prilli i vitit 2017, përveç pjesës së energjisë së prodhuar nga gjeneratorët BRE të cilët janë në kuadër të Skemës Mbeshtetëse.

Furnizimi me pakicë realizohet përmes furnizuesve dhe deri më tani Zyra e Rregullatorit për Energji ka licencuar tetë (8) furnizues, por vetëm furnizuesi KESCO është aktiv në treg. Për qëllim të sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjen e konsumatorëve me të drejtën e shërbimit universal, si dhe nevojës për rregullimin e çmimit të energjisë elektrike të blerësve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, ZRRE për një fazë tranzitore i ka vendosur Obligimin e Shërbimit Publik³ furnizuesit KESCO, i cili furnizon konsumatorët fundor që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal me çmime të rregulluara, e po ashtu deri më tani furnizon edhe konsumatorët tjerë me çmime të derregulluara, si dhe është emruar nga ZRRE si Furnizues i mundësisë së fundit.

Kosova si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë ka marr obligime për zbatimin e pakos së tretë të energjisë dhe në këtë aspekt, ZRRE, në vazhdimësi është duke nxitur zhvillimin e tregut

¹ https://mzhe-ks.net/repository/docs/MARREVESHJE_PER_FURNIZIM_ME_SHUMICE_-_tetor2012_KKDFE.pdf

² http://ero-ks.org/2019/Tregu/Procedura_per_Tregtimin_e_Energjise_Elektrike.pdf

³ http://ero-ks.org/2017/Vendimet/V_916_2017.pdf

konkurrues me shumicë dhe pakicë e cila mundëson që konsumatorët të përfitojnë çmime konkurruese, dhe për të implementuar këtë ka hartuar dhe aprovuar Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë⁴. Sipas këtij udhëzuesi, derregullimi i çmimit për konsumatorët fundor do të bëhet në mënyrë graduale, ku konsumatorët e kyçur në rrjetin e tensionit 220 kV dhe 110 kV tashmë furnizohen me çmime të derregulluara, kurse konsumatorët tjerë të kyçur në rrjetin e tensionit 35 kV, është e paraparë të furnizohen me energji me çmime të derregulluara duke filluar nga 31 mars 2020, ndërsa konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 10 kV është paraparë që të furnizohen me çmime të rregulluara deri më 31 mars 2021. Ndërsa detyrimet për OST, OT, OSSH dhe fondin e energjisë së ripërtritshme janë të rregulluara.

⁴http://ero-ks.org/2018/AktetUdhezimet/Udhezues_per_Ndryshimin_dhe_Plotesimin_e_Udheshuesit_per_Liberalizimin_e_Tregut_te_Energjise_Elektrike_ne_Kosove_13_qershor&30_tetor_2018.pdf

5. Tregu i energjisë elektrike me shumicë

Shitblerja në tregun e energjisë elektrike me shumicë kontrahohet nëpërmjet kontratave bilaterale dhe nëpërmjet tregut rajonal të organizuar të energjisë elektrike. Tregu bilateral i energjisë elektrike është tregu ku blerja dhe shitja e energjisë elektrike realizohet drejtpërdrejtë ndërmjet pjesëmarrësve në treg në bazë të marrëveshjeve bilaterale, duke respektuar Procedurën e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

Sipas ligjeve në fuqi pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike mund të lidhin kontrata për shitjen apo blerjen e energjisë elektrike me:

- ndërmarrje tjera të energjisë dhe me konsumatorë brenda Kosovës;
- ndërmarrje tjera të energjisë elektrike dhe konsumatorët në sistemet tjera të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë për aq kohë sa furnizuesit i zbatojnë rregullat e aplikueshme të tregtimit të energjisë së balancimit.

Qasja e pjesëmarrësve në tregun e energjisë në Kosovë konsiderohet të jetë e lehtë, licencimi i tyre bëhet nga ana e rregullatorit, e që sipas rezultateve të nxjerra nga anketa e zhvilluar nga ZRRE me furnizuesit e licencuar në Kosovë, është një procedurë e shpejt dhe e thjeshtë. Gjithashtu lehtësim tjetër është edhe mos obligimi për licencim i atyre tregtarëve të cilët posedojnë licencë në ndonjërin nga shtetet e tjera të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, duke respektuar parimin e reciprocitetit.

Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike në Kosovë janë kryesisht nga termocentralet të cilat përbëjnë rreth 95% të prodhimit vendor, dhe pjesa tjetër janë hidrocentrale, centrale me erë dhe panele fotovoltaike.

Prodhuesi më i madh ekzistues (KEK), në bazë të **Marrëveshjes për Furnizim me Shumicë**, është i detyruar të ofrojë sasinë e nevojshme të energjisë me prioritet tek furnizuesi (KESCO) për të furnizuar konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal. Pjesën e mbetur të gjenerimit e ofron për OST dhe OSSH për mbulimin e humbjeve me çmime të energjisë të caktuara me marrëveshje në mes të palëve (KEK-OST dhe KEK-OSSH). Tepërcat e energjisë elektrike, KEK i ofron në tregun e lirë dhe konkurrues bazuar në Procedurën për Tregtimin e Energjisë Elektrike.

HC Ujmani, si gjenerator në pronësi publike, deri në maj të vitit 2019, energjinë e prodhuar e ka ofruar te KESCO për konsumatorët me të drejtë të shërbimit universal. Ndërsa nga maji 2019, HC Ujmani përmes procesit të tenderimit, dhe duke respektuar procedurën për tregtimin e energjisë elektrike, ofron tërë prodhimin e tij në tregun konkurrues.

Prodhimi nga BRE trajtohet me prioritet në dispeçim, me çmime nxitëse për BRE brenda skemës mbështetëse duke ju garantuar një kontratë 10 vjeçare për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ujit, respektivisht 12 vjeçare për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e erës dhe panelet fotovoltaike, ndërsa BRE jashtë skemës mbështetëse prodhimin e tyre e ofrojnë në tri forma:

- me çmime përkatës (referente) të përcaktuar nga ZRRE në baza vjetore, sipas kornizës së Rregulluar;
- me çmime të dakorduara ndërmjet palëve konform marrëveshjeve ekzituese dhe me aprovim të ZRRE-së; dhe
- me çmime të bazuara në treg konkurrues.

5.1 Konkurrenca në tregun me shumicë

ZRRE-ja përmes udhëzuesit për liberalizimin e tregut ka iniciuar hapjen e tregut me shumicë duke e përshtatur edhe me rrethanat e sektorit të energjisë në Kosovë.

Ndër elementet thelbësore që sigurojnë një treg konkurrues dhe likuid, janë:

- oferta dhe kërkesa (numër i mjaftueshëm i blerësve dhe shitësve);
- qasjen jo-diskriminuese të Palës së Tretë në rrjet;
- trajtimi i mirëfilltë i subvencioneve në harmoni me ndihmën shtetërore.

Tregu i energjisë elektrike me shumicë ballafaqohet me: mungesën e tregut një-ditë-para, mungesën e furnizuesve të mjaftueshëm aktiv, mungesën e implemtimit të plotë të udhëzuesit për liberalizimin e tregut, si dhe me obligimet që rrjedhin nga Marrëveshja për Furnizim me Shumicë në mes të KEK dhe KESCO/KEDS. HC Ujmani që nga maji i vitit 2019 prodhimin e tij e ofron në treg të lirë, mirëpo ndikimi i këtij gjeneratori në tregun me shumicë është i vogël pasi që pjesëmarrja e tij në energjinë e prodhuar në vend është rreth 2%.

Që nga gushti i vitit 2018, prokurimi i energjisë elektrike për import dhe eksport bëhet duke respektuar **Procedurën për Tregtim të Energjisë Elektrike**, si: thirrja për tender, komunikimi me palët pjesëmarrëse, numri i mjaftueshëm i tregtarëve pjesëmarrës në ankande, çmimi më i favorshëm ekonomikisht, oraret kohore të tregtimit, etj, si dhe duke aplikuar marrëveshjen kornizë EFET.

Kosova dhe Shqipëria janë në proces të themelimit të bursës së përbashkët të energjisë APEX, si dhe bashkimin e tregjeve një-ditë-para, i cili përkrahë dhe ndihmon rritjen e konkurrencës dhe likuiditetin e tregut. Niveli i konkurrencës dhe likuiditetit rritet edhe me funksionalizimin e linjës 400 kV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, e cila ende nuk është në operim për shkak se KOSTT ende nuk është anëtare me të drejta të plota në ENTSO-E. Mos operimi i kësaj linje përveç tjerash ndikon edhe në mosgatishmërinë e furnizuesve që të operojnë në treg, duke ndikuar në ulje të konkurrencës.

6. Tregu i energjisë elektrike me Pakicë

Sipas legjislacionit në fuqi, furnizimi me energji elektrike është veprimtari e pavarur nga aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike i cili mbulon blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, përfshirë rishitjen për konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal dhe ata me çmime të parregulluara.

Për të përkrahur konkurrencën në tregun me pakicë, tregu i energjisë elektrike iu është nënshtruar reformave, duke ju përshtatur kërkesave të dala nga direktivat evropiane përkatëse. Njëra nga reformat efektive në tregun tonë është mundësia e konsumatorit për ndërrimin e furnizuesit, e cila sigurohet përmes **Rregullës për ndërrimin e Furnizuesit**⁵, e aprovuar nga ZRRE në tetor të vitit 2016. Përmes kësaj mundësie, konsumatorët mund të ndërrojnë furnizuesin, që ndikon direkt tek sjellja e furnizuesve në treg dhe njëkohësisht inkurajon konkurrencë dhe likuiditet në tregun e energjisë elektrike.

Në tregun me pakicë të energjisë elektrike, blerja e energjisë mund të jetë proces i komplikuar, veçanërisht për konsumatorët që nuk kanë njohuri të mjaftueshme për sektorin e energjisë. Nga përvoja e hapjes së tregut me pakicë në vendet tjera, informimi dhe edukimi i konsumatorëve është faktori kyç për funksionimin e një tregu konkurrues dhe transparent. Deri më tani nga ZRRE janë licencuar 8 subjekte juridike për furnizim me pakicë me energji elektrike, të cilat kanë plotësuar kriteret për këtë aktivitet, e të cilat janë: KESCO, HEP Energjia KS, GSA Energy, Future Energy Trading And Exchange Dynamics, Jaha Company, Korporata Energjetike e Kosovës-KEK, SharrCem, dhe Enerco LLC. Megjithatë, përveç KESCO e cila iu shërben rreth 600,000 konsumatorëve (100% e tyre), në Kosovë nuk ka furnizues të tjerë aktiv.

6.1 Konkurrenca në tregun me pakicë

Prezenca e konkurrencës në tregje rezulton me përmirësime të konsiderueshme në produktivitetin dhe efikasitetin e brendshëm të kompanive të energjisë elektrike, por përfituesi kryesorë në këtë proces është konsumatori fundor.

Konkurrenca duhet në parim të kontribuojë në efikasitetin e sistemit, duke i përballur konsumatorët me kostot reale të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Në të njëjtën kohë, kompanitë tregtare mund të ofrojnë çmime më të qëndrueshme dhe mekanizma sigurimi për ata konsumatorë që nuk janë të gatshëm të marrin një rrezik në afat të shkurtër. Procesi i liberalizmit të tregut në nivelin e furnizimit me pakicë me energji elektrike mbështetet me anë të rregullave siç janë: Rregulla për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal, Rregulla për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit dhe Rregulla për Ndërrimin e Furnizuesit.

Konkurrenca efektive në tregun e furnizimit me pakicë me energji elektrike është kryesisht e kushtëzuar nga konkurrenca në tregun e furnizimit me shumicë në Kosovë dhe kryesisht në nivelin e gjenerimit. Duke pasur parasysh obligimet që dalin nga **Marrëveshja për Furnizim me Shumicë** lidhur mes KEK dhe

⁵ http://ero-ks.org/2016/Rregullat/Rregulla_per_Nderrimin_e_Furnizuesi_final.pdf

KEDS (KESCO), kjo rezulton në kufizimin e likuiditetit në tregun me pakicë, si dhe likuiditetin në gjenerim, që pengon edhe konkurrencën.

Për të parë nga afër problemet dhe pengesat e furnizuesve, ZRRE ka zhvilluar një anketë me furnizuesit e licencuar në Kosovë, me anë të së cilës ka arritur të nxjerr rezultate lidhur me nivelin e konkurrencës në treg.

Rezultatet e fituara nga ky anketim tregojnë se një nga pengesat e zhvillimit të konkurrencës në tregun e energjisë elektrike, është edhe Marrëveshja për Furnizim me Shumicë e lidhur në mes të KEK dhe KEDS, me rastin e privatizimit të KEDS si operator i rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit. Poashtu sipas rezultateve të anketës, ndikim në konkurrencë të ulët ka edhe mungesa e qasjes së furnizuesve në informata të mjaftueshme rreth profilit të ngarkesës së konsumatorëve të energjisë elektrike në Kosovë.

Në funksion të përmirësimit të konkurrencës në tregun me pakicë të energjisë elektrike në vend, ZRRE me ndihmën e Agjencisë Kombëtare të Komisioneve Rregullative të Shërbimeve Publike - NARUC⁶, është duke punuar në krijimin e Mjetit për krahasimin e çmimeve (MKÇ) të energjisë elektrike, që do të ju mundësojë konsumatorëve, që në një treg të hapur, të kenë një burim të besueshëm për të krahasuar çmimet që do të ofrojnë furnizuesit e energjisë elektrike.

⁶ NARUC (National Agency of Regulatory Utilities Commissions) është Agjencia Kombëtare e Komisioneve Rregullative të Shërbimeve Publike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) - <https://www.naruc.org/>

7. Indeksi Herfindahl - Hirschman (HHI)

Për ta vlerësuar nivelin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në vend, është aplikuar edhe indeksi Herfindahl - Hirschman (HHI), i cili matë përqendrimin e tregut në mënyrë që të përcaktojë nëse tregu është konkurrues apo me tendencë monopoli. Vlera e HHI ndryshon nga 0 deri 10.000, dhe sa më e lartë të jetë vlera e treguesit, aq më i përqendruar është tregu. Indeksi mund të jetë 10.000 nëse ekziston vetëm një pjesëmarrës aktiv i tregut në një pozicion monopoli nga ana e furnizuesit. Kur vlera e indeksit është mbi 5.000, përqendrimi i tregut është shumë i lartë, derisa edhe një vlerë e indeksit mbi 1.800 konsiderohet si vlerë e lartë. Kjo vlerë mund të konsiderohet të jetë një prag, pasi që përqendrimi i tregut mbi këtë vlerë mund të çojë në mundësinë e abuzimit të një pozicioni mbizotërues të tregut. Një vlerë e indeksit HHI midis 1.000 dhe 1.800 tregon një treg të përqendruar mesatarisht, deri sa indeksi nën vlerën 1.000 tregon se tregu është i dekoncentruar.

Tregu i energjisë elektrike me shumicë dominohet nga gjeneratori KEK i cili mbulon rreth 90% të kërkesës së tregut vendor, derisa pjesa tjetër e kërkesës së tregut mbulohet nga gjeneratorët tjerë në vend dhe importi. Poashtu në bazë të obligimeve që dalin nga **Marrëveshja për Furnizim me Shumicë**, KEK do t'ia shesë KEDS-it tërë energjinë elektrike që mund të furnizohet nga stabilimentet e tij, të cilën KEDS mund ta kërkojë kohë pas kohe sipas kësaj Marrëveshjeje. Kjo kufizon mundësitë reale për konkurrencë në tregun me shumicë të energjisë elektrike, dhe redukton mundësin e ushtrimit të aktivitetit të furnizuesve në kushte të barabarta në treg.

Sipas gjendjes aktuale të tregut të energjisë me shumicë, Indeksi HHI rezulton të jetë 9,115, që tregon se ekziston koncentrim shumë i lartë i prodhimit në treg.

Rezultati i matjeve të HHI për nivelin e konkurrencës në tregun me pakicë në vend është 10,000, prandaj duke u nisur nga vlerat e treguesve të këtij indeksi, ZRRE konstaton se tregu me pakicë në vend është i përqendruar në masë shumë të lartë, pasi që, edhe pse janë 8 furnizues të licencuar, vetëm njëri nga ta (KESCO) ushtron aktivitetin e tij në treg, dhe ka 100% të pjesëmarrjes në treg.

8. Konkluzione

Bazuar në Legjislacionin primar të sektorit të energjisë (që është pjesërisht në përputhje me Direktivat Evropiane), si dhe në kriteret për vlerësimin e konkurrencës në furnizim me energji elektrike, ZRRE ka përgatitur këtë raport për vlerësimin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.

Poashtu sipas kërkesave të legjislacionit, ZRRE-ja dhe AKK-ja obligohen të nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi si dhe të monitorojnë konkurrencën dhe të parandalojnë praktikën anti-konkurrese në sektorin e energjisë elektrike. Megjithatë deri më tani ende nuk është nënshkruar një memorandum i tillë.

Në bazë të analizimit të kriterëve të konkurrencës të përcaktuara në vendimin e ZRRE, V_342_2011, përfshirë edhe rezultatet e dhëna nga indikatorit për matjen e përqendrimit të tregut (HHI) për gjendjen aktuale të tregut, si dhe në bazë të të gjeturave nga ky raport i cili përfshinë analizat dhe hulumtimet e bëra lidhur me funksionimin e tregut dhe nivelin e konkurrencës, ZRRE ka nxjerrë këto përfundime:

Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike në Kosovë janë kryesisht nga termocentralet të cilat përbëjnë rreth 95% të prodhimit vendor, dhe pjesa tjetër janë hidrocentrale, centrale me erë dhe panele fotovoltaike.

Prodhuesi më i madh ekzistues (KEK), është pjesëmarrësi me hisen më të madhe të prodhimit në tregun e energjisë në vend. KEK ka **Marrëveshje për Furnizim me Shumicë** me KESCO/KEDS me të cilën obligohet që tërë energjinë e nevojshme për furnizimin e konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal të ia ofroj me prioritet KESCO-s si FSHU, ndërsa pjesën e mbetur të energjisë, e ofron për mbulimin e humbjeve në sistem, sipas udhëzimeve në letrën e ZRRE “Trajtimi i energjisë me shumicë”. Po ashtu duhet theksuar se tepricat e energjisë elektrike (pas mbulimit të kërkesës së konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal dhe humbjeve në sistem), KEK i ofron në tregun e lirë dhe konkurren bazuar në Procedurën për Tregtimin e Energjisë Elektrike, ku mundë të marrin pjesë të gjithë furnizuesit në mënyrë të barabart.

HC Ujmani është gjeneratori i cili i nënshtrohet kushteve të konkurrencës së plotë, dhe shitjen e energjisë e bënë sipas Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike. Ndikimi i këtij gjeneratori në tregun me shumicë është i vogël duke pasur parasysh se pjesëmarrja e tij në energjinë e prodhuar në vend është vetëm rreth 2%.

Prodhimi nga gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë Elektrike nuk trajtohet sipas parimeve të tregut të lire dhe konkurren, sepse këta gjenerator kanë marrëveshje për shitblerje të energjisë sipas skemës mbështetëse me tarifa nxitëse, dhe poashtu ndikimi i tyre është i vogël në nivelin e konkurrencës.

Edhe mosnjohja e KOSTT si zonë rregulluese, dhe si rrjedhojë e sajë, mos operimi i linjës ndërkufitare 400 kV Kosovë-Shqipëri, përveç kufizimit të aftësive operuese të furnizuesve në Kosovë, vështirëson edhe procesin e bashkimit të tregjeve një-ditë-para Kosovë – Shqipëri e që ka ndikim në konkurrencën dhe likuiditetin e tregut të energjisë në Kosovë.

Deri më tani janë të licencuar 8 (tetë) furnizues, mirëpo aktualisht të gjithë konsumatorët furnizohen nga furnizuesi i vetëm aktiv (KESCO), përfshirë konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal me çmime të rregulluara, si dhe konsumatorët me çmime të parregulluara.

Pavarësisht se me legjislacionin në fuqi, konsumatorëve ju garantohet e drejta për të ndërruar furnizuesin e tyre, megjithatë në praktikë një gjë e tillë është pothuajse e pamundur pasi që, siç është cekur edhe më lartë, KESCO është i vetmi furnizues aktiv.

Poashtu implementimi i pjesëshëm i Udhëzuesit për Liberalizim të Tregut; cmimet e ulta të furnizimit të konsumatorëve me të drejtën e shërbimit universal si dhe obligimet e dala nga **Marrëveshja për Furnizim me Shumicë**, mundë të kenë ndikim në ulje të konkurrencës.

Nga të gjeturat që u than më lartë dhe rezultatet e përfituara nga anketa e zhvilluar me furnizuesit e licencuar në Kosovë, si dhe në bazë të rezultateve të përfituara nga Indeksi për Matjen e Përqendrimit të Tregut (HHI), ZRRE konstaton se përqendrimi në tregun e energjisë me shumicë dhe pakicë është shumë i lartë, që nënkupton se tregu i energjisë në vend për periudhën e analizuar ballafaqohet me **mungesë të konkurrencës**.

Në bazë të rezultateve të dala nga ky raport, më poshtë janë paraqitur rekomandimet lidhur veprimet që duhet ndërmarrë lidhur me konkurrencën në tregun e energjisë elektrike në Kosovë:

- ZRRE në bashkëpunim me AKK të filloj një hetim që ka të bëjë me rrespektimin e procedurës për tregtimin e energjisë nga pjesëmarrësit e tregut lidhur me tregtimin e energjisë elektrike;
- AKK të filloj një hetim (pasi që sipas MFSH, ZRRE nuk është *autoritet kompetent*, shih shtojca 1, pjesa 1, përkufizimet) që ka të bëjë me ndikimin MFSH-së në tregun e energjisë elektrike në vend, duke pasur parasysh se kjo marrëveshje mundë të ketë ndikim në konkurrencë
- Të intensifikohet largimi i konsumatorëve nga Furnizimi me tarifa të rregulluara sipas Udhëzuesit për Liberalizimit të Tregut të Energjisë Elektrike;
- Të vazhdohet me krijimin e Mjetit për krahasimin e çmimeve të energjisë elektrike që konsiderohet si një burim i besueshëm për të krahasuar çmimet që do të ofrojnë furnizuesit e energjisë elektrike.

FUNDI I DOKUMENTIT